



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Autoriteti i Aviacionit Civil Kosovës
Civil Aviation Authority of Kosovo

Titulli i Dokumentit	2022/ZDP/01	Titulli i Dokumentit	01/2022
Numri i Dokumentit	1	Numri i Dokumentit	
Specifikimi		Specifikimi	
Prezantuesi		Prezantuesi	
Datimi i Dokumentit		Datimi i Dokumentit	
Prezantuesi		Prezantuesi	

01/ZDP/VE/2022
Datë: 12 janar 2022

Në pajtim me nenin 61 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, dt. 4 qershor 2008), neni 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019), neni 34 paragrafi 4 të Rregullores (AAC) nr. 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit dhe ndryshimin e Rregullores (AAC) nr. 10/2015 dhe shfuqizimin e Rregullores (AAC) nr. 11/2009, Rregullores (AAC) nr. 03/2009 dhe Rregullores (AAC) nr. 6/2009, si dhe Rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

1. Revokohet Certifikata e Aerodromit me Nr. Ref. RKS.ADR.C.001, e lëshuar më datën 08 nëntor 2018 për LIMAK Kosovo International Airport Sh.A. nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Më datën 21 dhjetor 2021, AAC ka lëshuar Certifikatën e Aerodromit me Nr. Ref. RKS.ADR.C.002, për LIMAK KOSOVO International Airport Sh.A. përmes së cilës certifikatë LKIA është e autorizuar të operojë Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr. 17/2017, me ndryshime dhe plotësime, bazën e certifikimit të aerodromit, kushtet e certifikatës dhe manualin e aerodromit. Lëshimi i kësaj Certifikate ka për konsekuencë rëkuvimin e Certifikatës paraprake të LKIA sh.a. me nr. ref. RKS.ADR.C.001 të dt. 08 nëntor 2018.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 61 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, si dhe nenin 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, neni 34 paragrafi 4 të Rregullores (AAC) nr. 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit në përputhje me Rregullores nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngri konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.

Iu dërgohet:

- LIMAK Kosovo International Airport Sh.A.
- Arkivi të AAC-së.

